REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. **Tiranë ___/___/2017**
Nr. Dok. 201602396/4

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave nga ana juaj për hapjen e procesit gjyqësor për ndreqjen e gabimeve materiale në mbiemër të shtetasit A. M. nga qyteti i Korçës.*

Drejtuar : **Z. Kolë HYSENAJ**
Drejtues i Prokurorisë Rrethit Gjyqësor
KORÇË

Për dijeni : **Z.ADRIATIK LLALLA**
PROKUROR I PËRGJITHSHËM
TIRANË

Z.Ahmet MYFTARAGO
Lagja Nr.18, Rr."Theodhoraq Saro", Ap.8
KORÇË

I nderuar Z.Hysenaj,

Në ankesën e tij datë 24.11.2016, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi A. M. nga qyteti i Korçës, ankohet ndaj organit Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Korçë, se ky organ shtetror pa shkaqe ligjore nuk kryen detyrimet e vendosura nga vendimi gjyqësor i formës së prerë me Nr.34 datë 18.07.2016, të Gjykatës së Apelit Korçë.

Ankuesi nga ana e tij na shkruan se në disa raste ai i është drejtuar me kërkesë me shkrim këtij organi të ndjekjes penale dhe prej tij nuk ka marrë asnjë përgjigje me shkrim.

Ka qënë kjo arsyeja që shtetasi A. M. nga ana e tij me datën 24.11.2016, i është drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, i cili ka kërkuar shpjegime me shkrim në dy raste Drejtuesit Prokurorisë Korçë me datë 12.12.2016, dhe me datë 16.02.2017, dhe përsëri nga ana juaj nuk ka patur asnjë lloji reagimi dhe nuk kthehet një përgjigje zyrtare.

Janë pikërisht këto arsyet ligjore që institucioni i Avokatit të Popullit mendojë të ndërhyhet pranë jush me rekomandim për marrjen e masave konkrete duke kërkuar edhe ndihmën e organit qëndror të akuzës për zgjidhjen e këtij problemi sa më shpejtë në të ardhmen.

Nga verifikimet e kryera nga ana jonë ka rezultuar se shtetasi A. M. me vendimin penal Nr.5 datë 19.01.1996 të Gjykatës Ushtarake Korçë, është dënuar me 15 vjet heqje lirie. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin datë 22.02.1996 të Gjykatës së Apelit, dhe ai ka vuajtur dënimin me burgim deri në mars 1997 kur janë hapur burgjet.

Shtetasi A.M., tani ndodhet person në kërkim nga viti 2009 nga Drejtoria e Policisë Qarkut Elbasan dhe në bazë të nenit 68/b të Kodit Penal, ai i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila me vendimin Nr.161 datë 08.06.2016 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesës për moslegjitimim të kërkesës. Kundra këtij vendimi

shtetasi A. M. është ankuar në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila me vendimin Nr.34 datë 18.07.2016 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së pare.

Në arsyetimin e vendimit gjyqësor thuhet se:"Organi i Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Korçë, duhet apo mund të inicojë një proces gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, për ndreqjen e gabimeve materiale në mbiemër dhe vetëm pas kësaj ndreqje materiale ankuesi A. M. mund të legjitimohet në ngritjen e këtij kërkimi".

Në këto kushte dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 63/3 të Kushtetutës së RSH ku përcaktohet se:"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike", dhe kërkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999"Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se:

"Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandim për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të drejtave dhe lirive", Ju

R E K O M A N D O J M Ë :

1.Marrjen e masave për hapjen e procesit gjyqësor, për ndreqjen e gabimeve materiale të shtetasit A. M. nga qyteti i Korçës.

2.Mbi masat e marrja nga ana juaj, në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda afatit prej 30 ditësh,

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI